# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-463927**

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dosja e ‘SHISH’ - |
| ADRESA | `https://www.syri.net/kronike/918617/do-perfundojme-keq-shpirt-angazhimi-i-vlora-hysenit-per-te-shpetuar-agasin-drejtoresha-u-pyet-5-dite-para-arrestimit/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 19:04:46 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 09:57:10 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b04b9eb46683a8937c2bcac9276f318977c27972d9f72c5ed1ad07a017bfd147` |
| TEKSTI | `989e90d0c8502e8d3237a7741bcd9e36590cfec5f4049ac0f3f8115951d818c3` |
| PAMJA | `399c7447abcdf09d992d18c95b01b152fb62a9db2d805f61ef6b50c4bbeb526a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `70ba80e3d9b223864afa678f46968f0521b3a8aed98c3353f1eeab46c98568ca` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/70ba80e3d9b223864afa678f46968f0521b3a8aed98c3353f1eeab46c98568ca`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

syri









# 'Do përfundojmë keq, shpirt'/ Angazhimi i Vlora Hysenit për të shpëtuar Agasin. Drejtoresha u pyet 5 ditë para arrestimit

11:57, 23/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

\+ A[a] -

Më 18 shtator, Vlora Hyseni është marrë në pyetje nga agjentët e Byrosë Kombëtare të Hetimit si person në dijeni, teksa kërkesa e SPAK për arrestimin e saj kishte rreth 5 ditë që priste vendimin e Gjykatës së Posaçme.

Mësohet se Hyseni ka pranuar kontaktet me Ergys Agasin gjatë kohës që ky i fundit ndodhej në arrati, por mohon se e ka takuar fizikisht, por ndryshe dyshon organi hetues.

Hyseni ka pretenduar se me Agasin ka patur kontakte në cilësinë e bashkëpunëtorit, njësoj, siç pretendon ajo, ka me shumë persona të tjerë në cilësinë e kryeagjentes së SHISH.

Por SPAK nga ana tjetër pretendon se marrëdhënia mes tyre ka qenë më shumë se profesionale.

Në automjetin e sekuestruar të Ergys Agasit në "Equos Resort", janë gjetur disa materiale, të cilat dyshohet se ishin të Shërbimit Informativ të Shtetit.

"Zemër, thjesht duhet të koncentrohemi tek halli jot", "Të gjithë ne" dhe "Do përfundojmë keq, shpirt", mësohet të jetë një nga fragemtentet e shkëputura nga dosja hetimore.

Sipas të njëjtave burime, SPAK disponon edhe pamje filmike të takimeve dhe mes tyre që rrëzojnë pretendimin e Hysenit se me Agasin ka patur vetëm biseda telefonike në cilësinë e bashkëpunëtorit.

Ndërkohë mësohet se një pjesë të kohës që ishte në kërkim për dosjen e AKSHI-t, ka qëndruar pranë vilave qeveritare në Durrës, ku dyshohet se është ndihmuar nga Hyseni për t'iu shmangur arrestimit, por pavarësisht zërave nëse ka vënë në dispozicion mjete dhe pajisje të SHISH, për diçka të tillë, kjo nuk u arrit të konfirmohej nga interesimi për çështjen.

më të lexuarat

Humb jetën 32-vjeçarja britanike në një hotel në Jalë

Zjarri në Gjirin e Lalzit vijoi gjatë natës, u evakuuan turistë e banorë

Vrasja në Itali, shqiptari nuk kishte vjedhur asgjë, autori: Ndihem i dëshpëruar

Trafik i rënduar në aksin Lezhë-Milot, qytetarët prej disa orësh të 'bllokuar'

Artan Hoxha: Jo vetëm Vlora Hyseni, në telefonin e Gysit u gjetën telefonata edhe me Ramën

Shiste kanabis me përqindje të lartë THC-je, arrestohet 26-vjeçari! Ja çfarë iu sekuestrua

Menaxheri i "Kodrës së Kuajve", i çonte ushqim dhe sende të tjera të bevojshme Agasit sipas SPAK, pavarësisht se ishte në dijeni të pozitës ligjore duke përkrahur kështu një person në kërkim./**F.Gjinaj - Syri.net**

© SYRI.net

Lexo edhe:


Arrestohet në Rusi grosisti i kokainës Shpëtim Aliu


Gjirokastër/ Neutralizohet zjarri pranë Liqenit të Viroit pasi dogji sipërfaqe të konsiderueshme


E përfshirë në dosjen e Ergys Agasit/ Ish drejtoresha e SHISH, Vlora Hyseni nesër para GJKKO

SPAK kontrolle në banesën e ish drejtorit të policisë së shtetit, Ilir Proda

Vdiq pasi ra nga ballkoni i hotelit në Golem/ Belgu ishte shef i njohur kuzhine në vendin e tij

Pezullohet nga detyra dhe firmoset 'arrest shtëpie' për Vlora Hysenin, drejtoreshën e SHISH

## TË NGJASHME

SYRI TV/ Vlora Hyseni u dorëzua në pikën kufitare të Vërmicës, drejtuesja e SHISH-it pritet të dalë në GJKKO

Një zjarr i përmasave të mëdha ka rënë në lagjen 'Partizani' mbi Spitalin e Vlorës

Syri Tv siguron detaje nga dosja, Hyseni informonte Agasin për takimet me Ramën

Ashpërsohet bojkoti i avokatëve, nga e hëna nuk marrin pjesë as në seancat për masat e sigurisë

SYRI TV/ Zjarret e shtatorit, djegin vendin, në gjirin e Lalzit digjet një banesë

70 thirrje me zë apo video të nisura nga Hyseni në drejtim të Agasit / Si ranë në duart e hetuesve përgjimet e forta

'Sa shumë gjëra na kanë bërë, por do ia hedhim o zemër'/ Zbardhen të tjera biseda mes Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.